

**BASHKIA GJIROKASTËR**  
NJOFTIM PËR DHËNIE ME QIRA

Autoriteti : BASHKIA GJIROKASTËR

Adresa: Bashkia Gjirokastër, Sheshi “Çerçiz Topulli”

1. Dhënie me qira të sipërfaqeve nga fondi kullor me konkurrim publik në pronësi të Bashkisë Gjirokastër , Zona Kadastrale 2277 , Numri i Pasurisë 871 e cila bën pjesë në Ekonominë Kullorë Krinë, Gjirokastër.

Qëllimi i dhënies më qira të fondit kullor me konkurrim publik në pronësi të Bashkisë Gjirokastër, Zona Kadastrale 2277, Numri i Pasurisë 871 e cila bën pjesë në Ekonominë Kullorë Krinë, Gjirokastër , e llojit “Kullotë” me sipërfaqe 437289 m2 ose 43.7289 ha, është dhënia në përdorim për zhvillimin ekonomik me destinacion ushtrimin e veprimtarive turistike kampingje etj , për qëllime pushimi, argëtimi.

2. Dhënie me qira të sipërfaqeve nga fondi kullor me konkurrim publik në pronësi të Bashkisë Gjirokastër, Zona Kadastrale 2277, Numri i Pasurisë 883 e cila bën pjesë në Ekonominë Kullorë Krinë, Gjirokastër.

Qëllimi i dhënies më qira të fondit kullor me konkurrim publik në pronësi të Bashkisë Gjirokastër, Zona Kadastrale 2277, Numri i Pasurisë 883 e cila bën pjesë në Ekonominë Kullorë Krinë, Gjirokastër , e llojit “Pyll” me sipërfaqe 251341 m2 ose 25.1341 ha, është dhënia në përdorim për zhvillimin ekonomik me destinacion ushtrimin e veprimtarive turistike kampingje etj , për qëllime pushimi, argëtimi.

3. Dhënie me qira të sipërfaqeve nga fondi kullor me konkurrim publik në pronësi të Bashkisë Gjirokastër, Zona Kadastrale 2277, Numri i Pasurisë 873 e cila bën pjesë në Ekonominë Kullorë Krinë, Gjirokastër.

Qëllimi i dhënies më qira të fondit kullor me konkurrim publik në pronësi të Bashkisë Gjirokastër, Zona Kadastrale 2277, Numri i Pasurisë 873 e cila bën pjesë në Ekonominë Kullorë Krinë, Gjirokastër , e llojit “Kullotë” me sipërfaqe 729657 m2 ose 72.9657 ha, është dhënia në përdorim për zhvillimin ekonomik me destinacion ushtrimin e veprimtarive turistike kampingje etj , për qëllime pushimi, argëtimi.

4. Dhënie me qira të sipërfaqeve nga fondi kullor me konkurrim publik në pronësi të Bashkisë Gjirokastër, Zona Kadastrale 3314, Numri i Pasurisë 881 e cila bën pjesë në Ekonominë Kullorë Qesorat, Gjirokastër.

Qëllimi i dhënies me qira të fondit kullor me konkurrim publik në pronësi të Bashkisë Gjirokastër, Zona Kadastrale 3314, Numri i Pasurisë 881 e cila bën pjesë në Ekonominë Kullorë Qesorat, Gjirokastër, e llojit “Kullotë” me sipërfaqe 418358 m<sup>2</sup> ose 41.8358 ha, është dhënia në përdorim për zhvillimin ekonomik me destinacion ushtrimin e veprimtarive turistike kampingje etj, për qëllime pushimi, argëtimi.

5. Konkurrimi do të zhvillohet më datë 15.01.2024 ora 12:00 në Sallën e Këshillit Bashkiak, Bashkia Gjirokastër

6. Çmimi dysHEME i qirasë, është : Kullotë: 138 600 (Njëqind e tridhjetë e tetë e gjashtëqind) lekë/ha në vit e përllogaritur sipas V.K.M nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/ përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore.

7. Afati i dhënies me qira të kësaj pasurie do të jetë tej afatit 10 (dhjetë) vjet.

8. Kushtet e pjesëmarrjes në konkurrim janë:

- a) Garanci financiare e mjaftueshme për përballimin e investimit të parashikuar në plan biznes.
- b) Të ketë të kontraktuar një specialist të fushës, ku në CV- në profesionale të tregohet përvoja në fushën e veprimtarisë.
- c) Vërtetim nga organet përkatëse shtetërore se subjekti nuk ka procese gjyqësore në ngarkim, hetim në proces, detyrime tatimore ose detyrime të tjera ndaj të tretëve.
- d) Vërtetim për shlyerjen e taksave, tarifave dhe detyrimeve vendore për vitin 2023.

9. Ofertuesit janë të lutur të paraqesin vetëm një ofertë, në datën dhe orën e caktuar dhe dokumentacionin si vijon:

- a) Kërkesë së bashku me të dhënat për sipërfaqen e kërkuar dhe gjeneralitetet e tyre.
- b) Çertifikatën e regjistrimit dhe Ekstraktin e regjistrimit në QKB për objektin e veprimtarisë.
- c) Projektin teknik të hartuar nga specialistë të licensuar ku janë trajtuar të gjithë elementët e nevojshëm për zhvillimin e veprimtarisë së kërkuar, ( i cili përmban hartën topografike me koordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në variantin PDF dhe në format elektronik në shkallë 1:10000 ku të jenë evidentuar elementët kryesorë si kufijtë natyrorë, relievi, objektet aktuale si dhe cdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, hartuar konform kërkesave të projektit)
- d) Planbiznesin dhe investimet që do të bëhen
- e) Të dhënat për kapacitetet teknike, stafin, makineritë dhe pajisjet që zotëron
- f) Planin e rehabilitimit të sipërfaqes dhe kthimin e saj në gjendjen e mëparshme
- g) Nivelin e punësimit në veprimtari
- h) Raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis nga ekspertë të çertifikuar
- i) Çmimin e qirasë së ofruar për ha/vit
- j) Afati i qirasë
- k) Adresën e subjektit, telefonit, e-mail dhe fax

Deklaratë se mban përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e deklarimeve në dokumentacionin e dorëzuar në konkurrim. Në rast konstatimi të të dhënave të rreme, në çdo rast, Komisioni e skualifikon subjektin konkurrues.

Oferta paraqitet në një zarf të mbyllur i cili duhet të përmbajë një kopje origjinale ose të noterizuar të dokumentacionit të ofertës dhe ku të përcaktohen qartë identiteti dhe adresa e personit fizik apo juridik të interesuar dhe të dorëzohen në zyrën e Protokollit të Bashkisë Gjirokastrë, para orarit të hapjes së ofertave.

Sigurimi i ofertës

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Formularin e Sigurimit të Ofertës,

Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës duhet të jetë sa 2% e vlerës së ofertës

Llogaritja bëhet : Vlera e qirasë X vitet e qirasë X 2%

10. Vlerësimi i ofertave do të bëhet sipas pikëve për kriteret e përcaktuara si më poshtë:

- a) Projekti teknik i veprimtarisë që do të ushtrohet, ( i cili përmban hartën topografike me koordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në variantin PDF dhe në format elektronik në shkallë 1:10000 ku të jenë evidentuar elementët kryesorë si kufijtë natyrorë, relievi, objektet aktuale si dhe cdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, hartuar konform kërkesave të projektit) ----- 20 pikë
- b) Plani i biznesit dhe investimet që do të bëhen----- 15 pikë
- c) Planin e rehabilitimit të sipërfaqes ----- 25 pikë
- d) Nivelin e punësimit në veprimtari ----- 5 pikë
- e) Masën e qirasë për ha/vit ----- 35 pikë

Informacion mbi dokumentet e konkurimit publik: dokumentet e ankandit mund të tërhiqen pranë autoritetit të dhënies me qera Bashkia Gjirokastrë

Dokumente me pagesë : Po X

Nëse po Monedha \_\_\_\_\_ Çmimi 1000 Lekë

Dokumentet standarde të ankandit përbëhen nga:

- Formulari i njoftimit
- Kërkesa për pjesëmarrje
- Formulari i ofertës
- Ftesa për ofertë
- Formulari i njoftimit të fituesit
- Formulari i publikimit të njoftimit të fituesit
- Procesverbali/et i/e komisionit të Vlerësimit të Ofertave